



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 14.06.2016

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRUAR NDËRSEKTORIAL PËR BREZIN
BREGDETAR

Në mbështetje të neneve 7, 8, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671 datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 14, datë 07.03.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e nismës për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar”, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
 - a) Relacioni i Planit;
 - b) Materiali hartografik:
 - i. Harta e Sistemit Urban;
 - ii. Harta e Sistemit Infrastrukturor;
 - iii. Harta e Sistemit Bujqësor;
 - iv. Harta e Sistemit Natyror;
 - v. Harta e Sistemit Ujor;
 - vi. Harta e Potencialeve dhe Zhvillimeve Turistike;
2. Gjatë hartimit të planeve të tjera sektoriale kombëtare, planeve të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar.

3. Ngarkohen Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësive, përfshirë Agjencinë e Zhvillimit Rajonal, Bashkitë Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë, Konispol, Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, për zbatimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në.
4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDIRAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMEZI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA FOA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

